

KONTRATË SHITBLERJE ME REZERVË
E KUOTAVE TË KAPITALIT THEMELTAR TË SHOQËRISË
“KPL” SH.P.K

Sot, më datë 29.05.2025 (dymijë e njëzetë e pesë), në selinë e shoqërisë “KPL” Sh.p.k, në Rrugën e “Dibrës”, Nr. 372, Ish-Kuzhina, Godina QSUT, Tiranë, nënshkruhet kjo Kontratë Shitblerje e Kuotave të Kapitalit themeltar të Shoqërisë “KPL” Sh.p.k (me rezervë), mes palëve me të dhënat e mëposhtme:

I. PALA SHITËSE:

Z. Ramazan TROKA, atësia Hajdar, lindur në Muriqan, më 10.02.1961 dhe banues në Tiranë, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, pajisur me letërnjoftimin (ID) me Nr. 034239174 dhe Nr. Personal G10210135P, në cilësinë e ortakut të vetëm të Shoqërisë “KPL” Sh.p.k, shoqëri e regjistruar më 14.01.1997, pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, me NIPT J71330002J, me seli në Rrugë e “Dibrës”, Nr. 372, Ish – Kuzhina, Godina QSUT, Tiranë, Shqipëri, *këtu e në vijim i quajtur “Pala Shitëse”*.

II. PALA BLERËSE:

Shoqëria “SORI – AL” Sh.p.k, regjistruar si person juridik në QKB me NUIS K31510059D, me adresë Rrugë “Faik Konica”, Pallati “Golden Park Residence”, Hyrja Nr. 1, Kati Nr. 1, Zyra Nr.1, përfaqësuar nga Administratori **Znj. Alma Tafani**, atësia Riza, lindur në Elbasan, më 09.12.1973 dhe banuese në Tiranë, madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, pajisur me letërnjoftim (ID) Nr. 034406007 dhe Nr. Personal H36209104V, *këtu e në vijim i quajtur “Pala Blerëse”*.

Më poshtë, për efekt të kësaj Kontrate, do të referohen veçmas si “Pala” dhe së bashku si “Palët”.

Hyrje dhe Kushtet Paraprake


- A) Shitësi është ortak i vetëm dhe zotëron 100 % (njëqind përqind) të kuotës të kapitalit themeltar të Shoqërisë “KPL” Sh.p.k., një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me NIPT J71330002J, me seli në Rrugë e “Dibrës”, Nr. 372, Ish-Kuzhina, Godina QSUT, Tiranë, Shqipëri, (në vijim referuar edhe si “Shoqëria”);
- B) Shitësi dëshiron t’i shesë Blerësit 100 % (njëqind përqind) të kuotës të kapitalit themeltar të Shoqërisë, (në vijim referuar edhe si “**Kuota**”), sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara në vijim;
- C) Blerësi dëshiron të blejë nga Shitësi 100 % (njëqind përqind) të kuotës të kapitalit themeltar të Shoqërisë, sipas kushteve dhe afateve të mëposhtme;
- D) Më datë 29.05.2025 përpara nënshkrimit të kësaj Kontrate nga palët, Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve të Shoqërisë, ka miratuar shitjen e 100% (njëqind përqind) të kuotës të kapitalit themeltar nga ortaku i vetëm Z. Ramazan Troka (në cilësinë e palës shitëse në këtë kontratë) tek Shoqëria “SORI – AL” Sh.p.k (në cilësinë e palës blerëse në këtë kontratë).

Palët, madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, vendosën të nënshkruajnë këtë Kontratë të Shitblerjes së Kuotave të Kapitalit Themeltar si vijon:

Neni 1

Objekti i Kontratës

1.1 Objekt i kësaj kontrate është shitja e **100% (njëqind përqind)** të Kuotës së Kapitalit Themeltar të Shoqërisë “KPL” Sh.p.k, të lirë nga çdo peng, privilegj, barrë, e drejtë



parablerje apo çdo të drejtë tjetër në favor të të tretëve, nga Ortaku i vetëm Z. Ramazan Troka, tek Blerësi Shoqëria "SORI – AL" Sh.p.k, e cila nëpërmjet përfaqësuesit të saj ligjor Znj. Alma Tafani, pranon dhe blen kuotën, sipas kushteve dhe afateve të parashikuara në këtë Kontratë.

Neni 2

Çmimi i shitjes dhe mënyra e pagesës

- 2.1 Palët kanë rënë dakort që çmimi i shitjes do të jetë në vlerën totale të kapitalit themeltar të Shoqërisë "KPL" Sh.p.k prej **45,000,000 Lekë (dyzetë e pesëmilion lekë)**, më poshtë quajtur "**Çmimi i Shitjes**".
- 2.2 Çmimi total i shitjes së 100% të kuotës së kapitalit themeltar në vlerën prej 45,000,000 Lekë (dyzetë e pesëmilion lekë) duhet të likujdohet nga blerësi brenda një afati 12 (dymbëdhjetë) muajor nga data e nënshkrimit të kësaj kontrate nga palët.

Neni 3

Kalimi i Titullit të Pronësisë

- 3.1 Palët kanë rënë dakort që transferimi i plotë i pronësisë së kuotave të kapitalit themeltar objekt kontrate nga Shitësi tek Blerësi do të bëhet me nënshkrimin e kësaj kontrate.
- 3.2 Në rast se me kalimin e afatit të përmendur në nenin 2.2, pala blerëse nuk do të ketë likujduar vlerën e plotë të shitjes prej **45,000,000 Lekë (dyzetë e pesëmilion lekë)**, atëhere palës shitëse i lind e drejta të kërkojë kthimin e 100% të kuotës së kapitalit themeltar në gjendjen e mëparshme, në emër të tij. Në këtë rast shitësi do t'i kthej blerësit të gjitha pagesat e kryera nga ai deri në atë moment.
- 3.3 Me nënshkrimin e kësaj kontrate dhe depozitimin e kësaj kontrate në Qendrën Kombëtare të Biznesit, blerësi merr përsipër të gjitha të drejtat dhe detyrimet e si ortak i vetëm i Shoqërisë "KPL" Sh.p.k, përfshirë të drejtën për të marrë pjesë në fitimet e shoqërise, detyrimet dhe pasivet e mundshme.

Neni 4

Detyrimet e Palës Shitëse

- 4.1 Shitësi garanton Blerësin se është pronari i vetëm dhe i ligjshëm i 100% të kuotës së kapitalit themeltar të Shoqërisë "KPL" Sh.p.k, objekt i kësaj kontrate.
- 4.2 Shitësi garanton Blerësin se Kuota objekt i kësaj Kontrate, është e lirë nga çdo peng, privilegj, barrë, e drejtë parablerje apo çdo të drejtë tjetër në favor të të tretëve.
- 4.3 Shitësi bie dakort që të bëhet regjistrimi dhe depozitimi i kësaj Kontrate në Qendrën Kombëtare të Biznesit, me rezervën që në rast se blerësi nuk do të likujdojë përfundimisht çmimin e shitjes të përcaktuar në pikën 2.1, brenda afatit të përcaktuar në pikën 2.2, atëhere shitësi do të ketë të drejtë të kërkojë kthimin mbrapsht të 100% të kuotës së kapitalit themeltar, në gjendjen e mëparshme në emër të tij.

Neni 5

Detyrimet e Palës Blerëse

- 5.1 Blerësi deklaron se blen Kuotën e Shitësit, sipas gjendjes së faktit dhe të së drejtës në të cilën ajo ndodhet në momentin e nënshkrimit të kësaj Kontrate.
- 5.2 Blerësi deklaron në përgjegjësinë e tij personale, se merr përsipër të likujdojë çmimin e parashikuar në nenin 2, sipas kushteve dhe afatit të parashikuar në këtë kontratë.
- 5.3 Në rast se Blerësi nuk arrin të likujdojë çmimin e shitjes së përcaktuar në nenin 2, pika 2.1 brenda afatit të përcaktuar në pikën 2.2, atëhere ai duhet t'i paguajë shitësit një penaltet në vlerën 1% (një përqind) të çmimi të shitjes si dhe t'i kthej shitësit 100% të kuotës së kapitalit themeltar objekt i kësaj kontrate.



Neni 6

Interpretimi i kontratës në tërësi

Çdo kusht apo formulim që mund të sjellë paqartësi do të interpretohet në kontekstin e tërësisë së Kontratës dhe në këndvështrimin e qëllimit që i shtyu palët të lidhin këtë Kontratë.

Neni 7

Legjislacioni i zbatueshëm dhe juridiksioni

Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin nga interpretimi ose zbatimi i kushteve të kësaj Kontrate, janë objekt shqyrtimi dhe gjykimi para Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Neni 9

Të tjera

- 9.1 Kontrata përbëhet nga 9 (nëntë) nene dhe hartohet në 3 (tre) kopje të barazvlerëshme. Çdo njëra prej tyre ka përmbajtje të njëjtë ligjore dhe secila palë do mbajë nga një kopje.
- 9.2 Qendrës Kombëtare e Biznesit i lind e drejta të bëjë regjistrimin e kontratës së shitjes së kuotave të kapitalit themeltar të Shoqërisë "KPL" Sh.p.k, duke berë transferimin e 100% të kuotës së kapitalit themeltar në emër të blerësit Shoqërisë "SORI – AL" Sh.p.k, me rezervën (kushtin) që blerësi të likujdojë përfundimisht çmimin e shitjes të përcaktuar në pikën 2.1, brenda afatit të përcaktuar në pikën 2.2.
- 9.3 Pas likuidimit përfundimtar të vlerës prej 45,000,000 Lekë (dyzetë e pesëmilion lekë), pala shitëse do të nënshkruajë një deklaratë lidhur transferimin e plotë të pronësisë së kuotës së kapitalit themeltar tek blerësi.
- 9.4 Në rast se blerësi nuk ka likuiduar përfundimisht çmimin e shitjes atëhere shitësi ka të drejtë të kërkojë nga QKB-ja kthimin mbrapsht të 100% të kuotës së kapitalit themeltar, në gjendjen e mëparshme në emër të tij.

* * *

PALËT KONTRAKTUESE

SHITËSI

RAMAZAN TROKA

BLERËSI

Shoqëria "SORI – AL" Sh.p.k
Administrator
ALMA TAFANI

